

**❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE**

Gener 2 është një nga kompanitë më të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tilla si: ndërtim, infrastrukturë dhe menaxhim projektesh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Gjatë 20 viteve të fundit, Gener 2, ka lënë gjurmë në tregun shqiptar dhe atë rajonal duke zhvilluar projekte strategjike me standartet më të larta ndërkombëtare e njëkohësisht duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

**❖ TITULLI I POZICIONIT TE PUNES**

Specialist Ligjor

**❖ DETYRAT KRYESORE**

- Harton memo informuese për ndryshimet ligjore në fushat e interesit të shoqërisë.
- Kryen veprimet dhe procedurat që kanë të bëjnë me aktivitetin e kompanisë pranë institucioneve të ndryshme, kryesisht QKB, DPPM, ASHK, dhe pranë portalit e-albania etj.
- Jep asistencë juridike për veprimtarinë e Drejtorisë Juridike dhe të Perputhshmerisë për problemet që mbulon ky i fundit dhe që i ngarkohen nga Menaxheri Ligjor.
- Realizon konsulta për çështje ligjore që lidhen me aktivitetin e shoqërisë GENER 2 dhe të Shoqërive të tjera të lidhura.
- Përgatit dhe revizionon kontratat juridike civile si të sipërmarrjes, shit-blerjes, bashkëpunimit, qirase, punesimit, shërbimit, etj.
- Kontrollon përpara nënshkrimit kontratat me klientet, insitucionet shtetërore, partneret dhe furnitorët, nëse ato janë në përputhje me kushtet specifike të Shoqërisë dhe mbrojnë interesat e saj të ligjshëm.
- Këshillime për ndërtimin e një marrëdhënie konkrete juridike për projektet ekzistuese dhe të reja të Shoqërisë.
- Përgatit materiale me karakter juridik (shkresa, kërkesa ankimore etj) për probleme që lidhen me natyrën e punës së drejtorisë, por dhe të vecanta që i ngarkohen nga strukturat vendimarrëse të GENER 2.
- Përgatitjen e opinionëve ligjore, kërkesave dhe të cdo akti tjetër që i drejtohet Paleve të Tretë.
- Raporton cdo ditë, dhe ben përmbledhjen e punëve të kryera, cdo javë tek Menaxheri Ligjor.

**❖ KRITERET KRYESORE**

Edukimi: Arsim i lartë, Juridik. Preferohet të ketë kualifikim në nivel pasuniversitar në fushën e juridikut.

Gjuhë të huaja: Anglisht

Njohuri kompjuterike: Paketa Microsoft Office

Eksperiencia e kërkuar: Mbi 10 vite eksperiencë pune.

Te gjithë te interesuarit, janë te lutur te dergojne CV nepermjet adreses se e-mailit [careers@gener2.al](mailto:careers@gener2.al) ose [info@gener2.al](mailto:info@gener2.al)

Afati i fundit i aplikimit eshte **data 05 Shkurt 2024, ora 17:00.**

\* Vetem kandidatet e perzgjedhur do te kontaktohen.

\* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 mbi “Mbrotjtjen e të dhënave personale”.